


Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës (neni 105 K.P.), kanosja serioze (neni 107 K.P.), përndjekja e vazhdueshme (neni 107a K.P.), ngacmimi i vazhdueshëm nëpërmjet telekomunikacionit ose një sistemi kompjuterik (neni 107c K.P.), nxitja për urrejtje (neni 283 K.P.), shpifja (neni 297 K.P.).

Kallëzimi dhe procedura penale janë parimisht falas për Ju.

Shoqërimi gjatë procesit

Në disa raste të veçanta viktimat e urrejtjes në rrjet kanë të drejtë për një shoqërim psikosocial dhe juridik që jepet **falas**.

 Për më shumë informacione luteni të aksesoni [justiz.gv.at](https://www.justiz.gv.at) > Service (Shërbimet) > Opferhilfe und Prozessbegleitung (Ndihma ndaj viktimave dhe shoqërimi gjatë procesit) > Informationsfolder Prozessbegleitung (Fletëpalosja Shoqërimi gjatë procesit).

Mund t'u drejtoheni edhe konsultoreve, si p.sh. #GegenhassimNetz (Kundër urrejtjes në rrjet) të organizatës ZARA. Atë e gjeni nën [zara.or.at/de/beratung](https://www.zara.or.at/de/beratung).

Duhet të ruani patjetër një screenshot të postimit si provë.

Dëftues botimi

Titullari i medias, botuesi dhe redaktori përgjegjës:
Bundesministerium für Justiz (Ministria federale e Drejtësisë)
[bmj.gv.at](https://www.bmj.gv.at)
Vjenë, në janar 2021

Si mund të mbrohem nga “urrejtja në rrjet”?

Keni qenë i/e ballafaquar para pak kohësh me një postim plot urrejtje dhe doni të mbroheni? Kjo fletëpalosje do t'ju udhëzojë hap pas hapi te cilat organizata mund të drejtoheni konkretisht.

Keni disa mundësi: Si hap të parë mund të kërkoni fshirjen e postimit të urrejtjes direkt te platforma. Përveç kësaj mund të kërkoni në gjykatë një urdhër ndalues ose të paraqitni një kërkesë për dëmshpërblim. Në polici mund të bëni një kallëzim penal.

Pra, Interneti nuk është një hapësirë pa ligj.

Kështu mund të mbroheni hap pas hapi, nëse bëheni objekt i "urrejtjes në rrjet":

Screenshot

Si fillim është mirë që të bëni një screenshot të postimit ose ta fotografoni. Duhet të keni kujdes që data të shihet patjetër. Më mirë është që të fotografoni përveç kësaj të gjithë fijen. Kjo Ju shërben më vonë si provë për postimin në rastin kur fshihet nga autori ose nga platforma.

Tani mund të vijoni me hapat e tjerë:

Fshirja e përmbajtjeve nga platforma e Internetit

Platformat e mëdha janë të detyruara të parashikojnë një sistem lajmërimi, si p.sh. një sipullë lajmërimi. Kështu mund të lajmëroni platformën direkt për postimin e urrejtjes.

Pavarësisht nga fakti a jeni fyer në një mesazh privat ose në një postim që mund të shihet nga të gjithë, mund të kërkonte nga platforma e Internetit fshirjen e postimit.

Si duhet të veproni?

- Lajmëroni platformën direkt për postimin nëpërmjet sipullës së lajmërimit dhe kërkonte fshirjen e tij.
- Platforma e Internetit do t'Ju informojë si do të veprohet me lajmërimin dhe në momentin kur postimi është fshirë.
 - Parimisht postimi duhet të fshihet në rast të një kundërligjshmërie evidente (thirrje për përdhunim, kërcënim me vrasje etj.) brenda 24 orëve.

- Nëse kundërligjshmëria e postimit duhet të verifikohet më hollësisht, platforma e Internetit ka në maksimum 7 ditë kohë.

Nëse postimi nuk fshihet, platforma do t'Ju informojë mbi mundësitë e ankimit.

Në gjyq

Si rregull kompetenca është e gjykatës së vendit ku i padituri ka vendbanimin. Megjithatë, nëse i padituri banon në një shtet tjetër të BE-së, mund t'i drejtoheni gjykatës së vendbanimit Tuaj. Për të ditur se cila gjykatë është kompetente, shënoni këtu kodin e postës: [justiz.gv.at](https://www.justiz.gv.at) > Gerichte (gjykatat) > Gerichtssuche (kërkimi i gjykatave).

Urdhër ndalues

Nëse platforma nuk e fshin postimin, edhe pse ia keni kërkuar, mund ta paditni. Për të mundësuar njoftimin e padisë, duhet të shënoni të dhënat e kontaktit të platformës. Ato i gjeni në dëftuesin e botimit.

Urdhri ndalues lëshohet kundër cenimit të dinjitetit Tuaj njerëzor në Internet dhe përfshin p.sh. fyerje të ndyra, thirrje për vrasje ose përdhunim.

Pavarësisht nga kjo mund të paditni patjetër autorin e postimit. Nëse nuk e dini emrin e autorit, mund t'ia kërkonte ofruesit të faqes në Internet emrin dhe adresën. Si alternativë mund të kërkonte - personalisht, nëpërmjet postës ose Internetit me kartën e qytetarit - pranë zyrës së

komunës ose bashkisë një informacion mbi vendbanimin nga Regjistri Qendror i Banorëve, nëse emri Ju është i njohur.

i Formularin për urdhrin ndalues e gjeni nën [justizonline.gv.at](https://www.justizonline.gv.at). Nëpërmjet kësaj platforme keni mundësi ta parashtroni padinë në mënyrë direkte. Për urdhrin ndalues duhet të paguani afërsisht 100 €.

Dëshmipërblimi sipas Ligjit mbi Mediat

Më tej mund t'i kërkonte titullarit të medias (p.sh. titullarit të një profili Facebook ose Instagram) nëpërmjet gjykatës një dëshmipërblim për shembull për përgojim të keq, fyerje, shpifje ose mosrespektimin e jetës private. Për këtë duhet të bëni një kërkesë te gjykata. Një kërkesë e tillë kushton afërsisht 270 €.

Kallëzim penal te policia

Në rastin kur përmbajtja e postimit të urrejtjes mund të jetë shkas për një dënim penal, mund të bëni një kallëzim te drejtoria më e afërt e policisë së landit.

Atë e gjeni nën [polizei.gv.at](https://www.polizei.gv.at) > Kontakt > Dienststellenverzeichnis (Lista e shërbimeve) > Ihr Bundesland (Landi Juaj federal).

Kallëzimin mund ta bëni edhe në rastin kur (ende) nuk e dini emrin e vërtetë të autorit. Në këtë rast prokuroria mund të marrë masa për identifikimin e tij.

Këto vepra penale të parashikuara në kodin penal austriak (K.P.) janë shembuj për postime urrejtjeje: